



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 17366 prot.

Shkodër, më 01.07. 2026

**VENDIM
Nr. 51, datë 30.06.2026**

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË PËLQIMIT DHE AUTORIZIMIN E KRYETARIT
TË BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË INVESTIMIT PËR
RIKONSTRUKSIONIN E TERRENEVE SPORTIVE NË KOMPLEKSIN “ZMIJANEJ”,
NË BASHKËPUNIM ME FSHF-NË**

Këshilli Bashkiak i Shkodrës, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2026, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e pëlqimit dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Shkodër për nënshkrimin e marrëveshjes së investimit për rikonstruksionin e terreneve sportive në kompleksin “Zmijanej”, në bashkëpunim me FSHF-në, sipas draftit të paraqitur nga administrata e Bashkisë, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23
Vota Kundër 7
Vota Abstenim 1
Zbardhur me datë 01.07.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

MARREVESHJE
PËR RIKONSTRUKSIONIN E KOMPLEKSIT SPORTIV ZMIJANEJ, SHKODËR

E lidhur sot ne Tiranë, më __. __. 2026 ndërmjet palëve:

- I. Federata Shqiptare e Futbollit** person juridik shqiptar, identifikuar me NIPT: J62008031T me seli në Tiranë, Rr. “Liman Kaba” Nd. 5, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr. 5, Kodi Postar 1019, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ilir Shulku, këtu e në vijim referuar si “**FSHF**”;
- II. dhe**
- III. Bashkia Shkodër**, me seli në Shkodër,, e përfaqësuar ligjërisht nga Z. Benet Beci, Kryetar i Bashkisë, në vijim referuar si “**Bashkia**”;

Bashkërisht referuar si “**Palët**”;

Hyrje

- FSHF, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për organizimin, administrimin dhe zhvillimin e futbollit në Republikën e Shqipërisë, ka si prioritet përmirësimin e infrastrukturës sportive në funksion të zhvillimit të lojës në të gjitha nivelet;
- Komiteti Ekzekutiv i FSHF-së ka miratuar bashkëpunimin për rikonstruksionin e kompleksit “Zmijanej” në Shkodër, përmes Vendimit Nr. ..., datë 2026;
- Qyteti i Shkodrës do të jetë një nga qytetet pritëse të aktiviteteve në kuadër të Kampionatit Evropian U-21 të vitit 2027, çka e bën të nevojshëm përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive futbolistike;
- Palët dëshirojnë të bashkëpunojnë në realizimin e këtij projekti në interes të komunitetit, promovimit të sportit dhe zhvillimit të mëtejshëm të futbollit në qytetin e Shkodrës;
- Atëherë, në konsideratë të dakordësisë dhe angazhimeve reciproke të përcaktuara më poshtë, palët bien dakord si vijon:

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i kuadrit të bashkëpunimit, si dhe i të

drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella të palëve, për realizimin e projektit të rikonstruksionit të kompleksit “Zmijanej” në Shkodër (në vijim “Projekti”).

Neni 2

Objekti

- 2.1 Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi ndërmjet palëve për financimin dhe realizimin e projektit të rikonstruksionit të dy fushave të kompleksit “Zmijanej” në Shkodër.
- 2.2 Në kuadër të këtij projekti do të kryhen punime për rikonstruksionin e bazamentit të dy fushave standarde të futbollit, sipas standardeve të përcaktuara nga UEFA/FIFA/IFAB dhe projektit të miratuar dhe të infrastrukturës përreth tyre, përfshirë punimet e betonit, drenazhimin, shtresave të fushës, instalimin e sistemit të vaditjes, portave dhe pajisjeve të mirëmbajtjes, si dhe çdo punim tjetër sipas preventivit dhe specifikimeve teknike të dakordësuara (bashkëlidhur).

Neni 3

Të drejtat dhe Detyrimet e FSHF

- 3.1 FSHF angazhohet të financojë dhe realizojë:
 - a) Sistemin e vaditjes për dy fushat sportive me bar natyral;
 - b) Procesin e mbjelljes së barit për dy fushat sportive me bar natyral;
 - c) Furnizimin dhe vendosjen e kompletit të portave dhe flamujve për dy fushat me bar natyral.
- 3.2 FSHF ka të drejtë të mbikëqyrë cilësinë e punimeve përmes ekspertëve të saj teknikë dhe do të verifikojë përputhshmërinë me standardet përkatëse.
- 3.3 FSHF ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë progresin e punimeve dhe materialet e përdorura.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Shkodër

- 4.1 Bashkia Shkodër angazhohet të financojë dhe të realizojë:
 - a) Punimet e nevojshme për bazamentin e dy fushave sportive me bar natyral;
 - b) Punimet e nevojshme për rrethimin e fushave;
- 4.2 Bashkia Shkodër do të jetë përgjegjëse për realizimin e të gjitha procedurave të nevojshme për zbatimin e punimeve të parashikuara në pikën 4.1 të kësaj marrëveshjeje si dhe ndjekjen dhe administrimin e procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- 4.3 Bashkia Shkodër angazhohet në marrjen e masave të nevojshme për mbulimin, reduktimin ose përjashtimin, sipas legjislacionit në fuqi, të taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë projekt.
- 4.4 Bashkia Shkodër angazhohet në sigurimin e dokumentacionit dhe akteve administrative që janë në kompetencën e saj dhe që kërkohen për realizimin e Projektit, përfshirë lejen e ndërtimit, kur kjo është e nevojshme.
- 4.5 Bashkia Shkodër merr përsipër, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kompetencat e saj, që FSHF të mos ngarkohet me asnjë taksë vendore, tarifë vendore, pagesë administrative apo detyrim tjetër financiar të natyrës vendore që lidhet me realizimin e Projektit, duke përfshirë edhe taksën e ndikimit në infrastrukturë, nëse është e aplikueshme. Çdo detyrim i tillë do të përballohet ose do të trajtohet nga Bashkia Shkodër sipas procedurave përkatëse.
- 4.6 Bashkia Shkodër merr përsipër për të kërkuar pelqimin e pronatit të tokës ku do të zhvillohet projekti.
- 4.7 Bashkia Shkodër angazhohet në garantimin e përdorimit pa pagesë të fushave sportive nga FSHF për zhvillimin e aktiviteteve futbollistike, në kuadër të Kampionatit Evropian U-21 të vitit 2027, sipas koordinimit ndërmjet palëve, si dhe për organizimin e aktiviteteve të tjera sportive dhe futbollistike të organizuara nga FSHF.

Neni 5

Afatet

- 5.1 Bashkia Shkodër dhe FSHF angazhohen të realizojnë punimet e bazamentit të dy fushave sportive sipas nenit 3 dhe nenit 4 nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje deri me 31.10.2026.
- 5.2 FSHF do të fillojë procesin e mbjelljes së tapetit me bar natyral menjëherë pas përfundimit dhe marrjes në dorëzim të punimeve të bazamentit nga Bashkia Shkodër.

Neni 6

Lidhja mes palëve

- 6.1 Palët deklarojnë që kjo Marrëveshje nuk krijon asnjë lidhje të veçantë ekonomike, juridike ose financiare mes tyre përveç detyrimeve të përcaktuara shprehimisht në të.
- 6.2 Palët angazhohen të bashkëpunojnë në mirëbesim gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit dhe të shkëmbejnë në kohë çdo informacion, dokumentacion ose akt që është i nevojshëm për realizimin e rregullt të tij.
- 6.3 Secila palë do të mbajë përgjegjësi për mospërmbushjen në kohë të detyrimeve që i ngarkohen nga kjo marrëveshje dhe nga legjislacioni në fuqi, në mënyrë që të mos pengohet realizimi i Projektit.

Neni 7

Mirëmbajtja

- 7.1 FSHF merr përsipër të garantojë mirëmbajtjen e fushave sportive të ndërtuara në kuadër të kësaj marrëveshjeje, para dhe gjatë periudhës së zhvillimit të kampionatit Evropian Under 21 në vitin 2027.
- 7.2 Bashkia Shkodër merr përsipër të garantojë mirëmbajtjen e objektit dhe kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme pas përfundimit dhe dorëzimit të punimeve, me qëllim ruajtjen e tij në gjendje të përshtatshme funksionale për një periudhe 2 vjecare.

Neni 8

Njoftimet

- 8.1 Njoftimet sipas kësaj kontrate duhet të jenë me shkrim dhe të dërgohen në adresën postare ose elektronike të mëposhtme:

Bashkia Shkodër:

Kontak: Tel: _____

Adresa postare: _____

Adresa elektronike: _____

Federata Shiptare e Futbollit:

Adresa postare: Rr. Liman Kaba, Nd 5, Hyrja 1, Njesia Administrative 5, Kodi Postar 1019, Tirane

Adresa elektronike: info @fshf.al

Neni 9

Zgjidhja e Marrëveshjes

- 9.1 Çdo mospërbushje që mund të sjellë zgjidhjen e kontratës duhet t'i njoftohet paraprakisht me shkrim Palës që është në shkelje.
- 9.2 Palët do përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e lindura gjatë ose për shkak të kësaj kontrate.

Neni 10

Informacioni konfidencial

- 10.1 Palët duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 10.2 Palët mund të shkëmbejnë dokumente të tilla, të dhëna ose informacione të tjera deri në masën e kërkuar për zbatimin e kontratës.
- 10.3 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose

çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, palët duhet t'i vendosin në dispozicion njëra-tjetrës të gjitha provat dhe informacionin në posedim të tij të cilat kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 11

Ndryshimi i punimeve

- 11.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt ri negocimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e saj. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe i firmosur nga Palët.
- 11.2 Përpara se të kërkojnë një ndryshim, Palët duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës, të volumeve të punimeve dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Punimet e ndryshuara duhet të materializojnë amendamentet e marrëveshjes.

Neni 12

Forca madhore

- 12.1 Asnjëra palë nuk mban përgjegjësi për mos përmbushjen ose përmbushjen me vonesë të detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, nëse kjo vjen si pasojë e një ngjarjeje të forcës madhore, e cila është jashtë kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur dhe nuk mund të parandalohet ose të kapërcehet me masa të arsyeshme.
- 12.2 Ngjarje të forcës madhore konsiderohen, ndër të tjera, lufta, trazirat, grevat, bllokadat, fatkeqësitë natyrore, zjarret, përmytjet, tërmetet, aktet e autoriteteve publike ose çdo rrethanë tjetër e jashtëzakonshme me natyrë të ngjashme.
- 12.3 Pala e prekur nga forca madhore detyrohet të njoftojë me shkrim palën tjetër brenda një afati të arsyeshëm nga momenti i ndodhjes së ngjarjes, duke paraqitur, kur është e mundur, edhe informacion mbi natyrën e saj, ndikimin në përmbushjen e detyrimeve dhe kohëzgjatjen e pritshme.
- 12.4 Gjatë kohëzgjatjes së ngjarjes së forcës madhore, përmbushja e detyrimeve të palës së prekur pezullohet në masën që ndikohet drejtpërdrejt nga kjo ngjarje. Palët do të marrin masat e nevojshme për të minimizuar pasojat dhe për të rifilluar përmbushjen e detyrimeve sapo rrethanat ta lejojnë.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 13.1 Kjo marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
- 13.2 Palët duhet të bejnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje, me negociata direkte.

- 13.3 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato do t'i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës kompetente.
- 13.4 Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Neni 14

Te ndryshme

- 14.1 Çdo heqje dorë nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të behen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.
- 14.2 Pas përfundimit të punimeve dhe dorëzimit të objektit, infrastruktura sportive e rikonstruktuar, përkatësisht dy fusha sportive në Kompleksin "Zmijanej", do të mbetet në administrim dhe përdorim të Bashkisë Shkodër, në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.
- 14.3 Asnjëra palë nuk mund të transferojë, kalojë ose cedojë tek të tretët të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

Neni 15

Gjuha e kontratës

- 15.1 Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë ligjore e ekzekutive.
- 15.2 Pasi u lexua me zë dhe u gjet në përputhje me vullnetin e lire të palëve, u nënshkrua si më poshtë.

Nënshkruar në Tiranë, më datë _____.____.2026 (data e hyrjes në fuqi).

**FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT
SHKODËR
Ilir Shulku
Sekretar i Përgjithshëm**

**BASHKIA
Benet Beci
Kryetar**